



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

PËRTEJ SHKAKTARËVE: RREZIQET E REJA TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË



Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor: Skender Perteshi

Revidimi i brendshëm: Florian Qehaja

Revidimi i jashtëm: Garentina Kraja

© Të gjitha të drejtat të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të Drejtat e Pronës Intelektuale nr. 04/L-065 dhe të Drejtat e Përafërta dhe Ligji Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem rikthimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik ose tjetër, pa lejen paraprake të botuesit. Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës.

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.



Kingdom of the Netherlands

Ky projekt u mbështet nga Ambasada e Holandës në Kosovë. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë ato të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Ambasadës së Holandës në Kosovë.



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**PËRTEJ SHKAKTARËVE:
RREZIQET E REJA TË EKSTREMIZMIT
TË DHUNSHËM NË KOSOVË**

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| SHËNIME PËR AUTORIN | 5 |
| AKRONIMET | 6 |
| PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME | 7 |
| GJETJET KRYESORE..... | 8 |
| METODOLOGJIA | 10 |
| HYRJE | 11 |
| KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR PAS MPOSHTJES SË ISIS | 14 |
| KONTEKSTI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË..... | 18 |
| DUKURIA E LUFTETARIT TË HUAJ TË KOSOVËS..... | 20 |
| FAMILJET KOSOVARE QË UDHËTUAN NË SIRI E IRAK..... | 22 |
| BOMBË E KURDISUR: LUFTËTARËT E HUAJ TË KTHYER DHE SIMPATIZANTËT E IS NË KOSOVË? | 26 |
| LUFTËTARËT KOSOVARË NGA DIASPORA | 30 |
| RADIKALIZIMI I VAZHDUESHËM I FAMILJEVE TË LHT | 33 |
| KONKLuzionet | 35 |

SHËNIME PËR AUTORIN

Hulumtuesi i QKSS, z. Skender Perteshi, ka diplomuar në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci në Kolegjin Universitar "Universum". Aktualisht drejton programin e QKSS për luftimin dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Skenderi është autori i shumë hulumtimeve që kanë të bëjnë me sigurinë, që nga integriteti në sektorin e sigurisë në Kosovë, rreziqet dhe vlerësimet e kërcënimeve të sigurisë kombëtare, parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, si dhe reforma e sektorit të sigurisë.

Ai ka punuar edhe si bashkëpunëtor dhe konsulent për organizatat ndërkombëtare dhe lokale në tema që lidhen me sigurinë, sidomos Fondacionin Finn Aid Foundation - Helsinki, Institutin RUSI, Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) dhe MOONSHOT me bazë në Londër. Interesat e tij kërkimorë përfshijnë terrorizmin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, radikalizimin online, shkaqet dhe pasojat e ekstremizmit të dhunshëm; rolin e komunitetit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm; integritetin në sektorin e sigurisë në Kosovë; bashkëpunimin rajonal në fushën e sigurisë; reformën në sektorin e mbrojtjes.

AKRONIMET

| | |
|-------------|---|
| ASL | Ushtria e Lirë Siriane |
| LHT | Luftëtarët e huaj terroristë |
| BIK | Bashkësia Islame e Kosovës |
| IS | Shteti Islamik |
| ISIS | Shtetik Islam i Irakut dhe Sirisë |
| QKSS | Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë |
| AKI | Agjencia e Kosovës për Inteligjencë |
| PK | Policia e Kosovës |
| BKS | Barometri Kosovar i Sigurisë |
| ShBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |

PËRMBLEDHJE E PËRGGJITHSHME

Humbja e territorit që mbahej nga IS dhe taktikat e ndryshueshme të organizatës terroriste, e cila po përpiqet përshtatet me ndryshimet e reja pas intervenimit ushtarak kundër tyre, krijuan kërcënime dhe sfida të reja për sigurinë në Evropë duke përfshirë Ballkanin Perëndimor dhe në Kosovën. Kërcënimi i ndikuar nga jashtë që lidhej me rekrutimin e luftëtarëve të huaj në Kosovë, tani po kalon gradualisht në terrorizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm të rritur përbrenda. Përderisa fluksi i luftëtarëve të huaj terrorist prej Kosovës, si dhe udhëtimi i tyre për në Siri dhe Irak ka rënë që nga viti 2015, kërcënimi nga ekstremizmi i dhunshëm është zhvendosur në rritjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit përbrenda Kosovës. Veç në dy vitet e fundit, Policia e Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës kanë parandaluar rreth katër tentim sulme terroriste në Kosovë – një numër i paprecedent sulmesh ekstremiste ideologjike ky që të jetë planifikuar ndonjëherë në vendin tonë.

Kërcënimi nga terrorizmi i zhvilluar përbrenda dhe radikalizimi i vazhdueshëm vjen nga disa drejtime. Ideologjitë ekstremiste të dhunshme ende janë të përhapura nëpër familjet e luftëtarëve të huaj nga Kosova, sidomos ato që ndjekin mësimet konservative. Këto familje ngurrojnë të pranojnë çfarëdo mbështetjeje nga autoritetet shtetërore dhe refuzojnë cdo lloj bashkëpunimi. Më parë, kërkojnë ndihmë nga grupet radikale fetare joformale që vazhdojnë të operojnë në Kosovë.

Një sfidë tjetër mbetet diaspora e Kosovës. Rreth 20 për qind e 403 luftëtarëve të huaj me origjinë nga Kosova kanë lindur ose janë rritur si brez i dytë ose i tretë të imigrantëve në shtetet e Evropës Perëndimore. Gjatë themelimit të “Shtetit Islamik”, këta individë ishin ndër luftëtarët e huaj më ekstremë, disa madje të angazhuar në akte terroriste ndërkombëtare në Evropë dhe Turqi dhe sulme vetëvrasëse në Siri e Irak. Shumica e këtyre luftëtarëve të huaj me prejardhje kosovare deri tash kanë qenë pak ose aspak të lidhur me Kosovën. Megjithatë, ka një indikacion se disa prej tyre po e shtojnë praninë në Kosovë dhe mund t’i forcojnë lidhjet familjare në rajon për ta rritur rrjetin e ndikimit për qëllime ideologjike.

Veç kësaj, rreth 190 qytetarë të Kosovës mbeten ende në Siri e Irak si pjesë e organizatave terroriste ose janë të arrestuar atje. Qeveria e Kosovës ka bërë përpjekje për t’i kthyer në Kosovë, duke përfshirë një numër të madh fëmijësh të lindur nga të paktën njëri prind kosovar gjatë konfliktit. Megjithatë, pavarësisht prej gatishmërisë së qeverisë për ta marrë pronësinë e çështjes, pa një program riintegrimi dhe me një popullatë që kryesisht nuk don t’i mirëpresë luftëtarët e huaj, kthimi i tyre dhe radikalizimi i vazhdueshëm në terren kanë gjasë të bëhen kërcënimi më i madh kombëtar i sigurisë deri më sot.

GJETJET KRYESORE

1. Numri i qytetarëve kosovarë që kanë udhëtuar në Siri e Irak ka rënë në mënyrë drastike. Që nga viti 2016, nuk është raportuar asnjë rast i qytetarëve të Kosovës që ka udhëtuar në Siri e Irak si pjesë e ndonjë organizate terroriste;
2. Kërcënimi nga ekstremizmi të dhunshëm, e shpalosur dikur nëpërmjet rekrutimit të luftëtarëve të huaj, tani është shndërruar gradualisht në terrorizëm I përhapur përbrenda në Kosovë;
3. Trendet ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë janë pothuajse të ngjashme me ato gjetiu në Evropë. Simpatizantët e rinjë të terrorizmit kanë më shumë potencial dhe aftësi për të ndërmarrë sulme terroriste krahasuar me luftëtarët e huaj të kthyer nga Siria e Iraku. Në katër vitet e fundit, shumica e sulmeve në Evropë u kryen nga simpatizuesit e IS ose “ujqit e vetmuar”, dhe më pak se një e pesta e sulmeveve terroriste me motivim fetar ishin vepra të sulmuesve që më parë kishin luftuar në Siri e Irak;
4. Policia e Kosovës dhe Agjencia Kosovës për Inteligjencë kanë parandaluar rreth katër sulme të mundshme terroriste në Kosovë gjatë dy viteve të fundit. Tentim sulmet terroriste u përgatitën nga simpatizantët e IS dhe përfshinin burra që nuk kishin marrë pjesë kurrë në konflikte në Siri e Irak. Deri më sot, asnjë sulm terrorist nuk është kryer në Kosovë;
5. Prej 135 ish-luftëtarëve të huaj nga Kosova, pesë janë përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në ndonjë aktivitet të lidhur me tentim sulme apo aktivitete terroriste në Kosovë, përfshirë sulmin e parandaluar nga autoritetet e Kosovës në ndeshjen kualifikuese të Kupës Botërore 2018 midis Shqipërisë dhe Izraelit;
6. Një nga 360 të kthyer në Evropë është përfshirë ose ka planifikuar një sulm terrorist pas kthimit nga përvoja luftarake me IS-in. Në Kosovë, një në 25 të kthyer është angazhuar në tentim sulme terroriste të dyshuara, që janë parandaluar nga autoritetet;
7. Një sfidë tjetër me ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë është se një numër i konsiderueshëm qytetarësh kosovarë që udhëtuan për në Siri e Irak posedojnë shtetësi të dyfishtë. Nga 255 luftëtarë të huaj kosovarë që udhëtuan për në Siri e Irak, 48 individë, ose 20% e totalit të LHT kosovarë, kanë lindur dhe janë rritur në vendet e Evropës Perëndimore, kryesisht nga prindër emigrantë që kanë ikur nga Kosova në vitet 1990. Shumica,

ose 14 luftëtarë të huaj me origjinë kosovare janë nga Gjermania, gjashtë nga Zvicra dhe katër janë amerikanë si dhe tjerë.¹ Disa nga këta individë janë kthyer në Kosovë ose në vendet ku kanë lindur pasi i janë bashkuar IS. Pjesa tjetër e luftëtarëve të huaj nga ky grup mendohet të jetë vrarë në fushëbetje.

8. Që nga viti 2012, rreth 403 persona kanë udhëtuar nga Kosova për në konfliktet në Siri e Irak si anëtarë të organizatave terroriste. Nga ky total, 255 janë burra, të njohur si luftëtarë të huaj, ndërsa pjesa tjetër janë gra e fëmijë. Bazuar në të dhënat e autoriteteve, rreth 40 fëmijë kanë lindur në Siri/Irak me të paktën njërin prind me prejardhje prej Kosovës. Rreth 135 individë janë kthyer në Kosovë dhe po kalojnë nëpër proces gjyqësor. Shtatëdhjetë e pesë LHT të Kosovës raportohet të jenë vrarë, ndërsa rreth 190 mbeten në territorin e IS-së.
9. Numri më i madh i luftëtarëve të huaj të Kosovës ka udhëtuar për në Siri e Irak gjatë vitit 2013 dhe në gjysmës së parë të vitit 2014 kur IS ishte ende po themelohej. Rreth 294 individë kosovarë nga Kosova kanë udhëtuar në Siri e Irak nga viti 2012 deri në gjysmën e parë të vitit 2014. Pjesa tjetër, ose rreth 82 luftëtarë të huaj nga Kosova, u larguan në fund të vitit 2014 dhe më 2015, një rënie të ndjeshme kjo.
10. Rreth 143 familje nga Kosova kanë udhëtuar në Siri e Irak. Në shumicën e rasteve udhëtimi e tyre e kishte iniciuar ose vendosur një anëtar i rritur i familjes. Deri në themelimin e të ashtuquajturit "Kalifat" në korrik 2014, pesëmbëdhjetë (15) familje të Kosovës udhëtuan për në zona konflikti. Pas shpalljes së "Kalifatit", familjet e shumë luftëtarëve të huaj të Kosovës u detyruan të udhëtonin atje. Në periudhën midis viteve 2014 dhe 2015, rreth 108 familje LHT nga Kosova u vendosën në "Kalifat", një hark kohor ky që përputhet me kulmin ekonomik, financiar dhe ushtarak të "Shtetit Islamik";
11. Relacionet e fuqisë ndërmjet gjinive në Kosovë, si shoqëri kryesisht patriarkale, ishin vendimtare për zhvendosjen e anëtarëve të familjes në arenën e luftës të IS. Në shumicën e rasteve, gratë dhe fëmijët paten trysni nga një anëtar i lartë i familjes, shpesh burri dhe babai, për të udhëtuar në territorin e IS-së. Gratë zakonisht i ndiqnin urdhrat e burrave për të udhëtuar në Siri e Irak.
12. Luftëtarët e huaj të Kosovës të kthyer pas qëndrimit jashtë vendit do të vazhdojnë të jenë kërcënim ose t'i ndikojnë të tjerët në Kosovë, si vëllezërit e motrat dhe kushërinjtë, duke përhapur ideologji të dhunshme ekstremiste, duke treguar histori personale të konfliktit në Siri e Irak si duke u lavdëruar për pjesëmarrjen e tyre në themelimin e Shtetit Islamik.

1 Po aty:

METODOLOGJIA

Për hartimin e këtij raporti, QKSS ka zbatuar një sërë teknikash të mbledhjes së të dhënave cilësore. Autori është mbështetur kryesisht në të dhënat e mbledhura më parë gjatë një periudhe gjashtëvjeçare, duke përfituar nga përvoja personale dhe raportet e shumta të QKSS mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, intervistat me luftëtarët e huaj, vizitat në komunitetin e tyre dhe diskutimet me anëtarët e familjeve të tyre. Janë shqyrtuar të gjitha raportet ndërkombëtare dhe vendore lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin në Kosovë për qëllimet e këtij raporti.

Ky studim bazohet në 20 intervista me LHT dhe anëtarët e familjeve të tyre nga komuna e rajone të ndryshme, të kryera gjatë vitit nga QKSS. QKSS është mbështetur edhe në të dhënat zyrtare dhe statistikak e ofruara nga agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë. Për qëllimet e këtij hulumtimi, QKSS ka përpiluar një bazë të dhënash të incidenteve ose sulmeve politike dhe fetare të kryera në Kosovë dhe jashtë kufijve të saj nga qytetarë me prejardhje kosovare. Kjo bazë të dhënash na ka ndihmuar t'i kuptojmë trendet e rëndësishme, t'i kontekstualizojmë dhe t'i vlerësojmë rreziqet dhe kanosjet që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë.

Veç kësaj, për këtë raport, QKSS ka përfituar edhe nga gjetjet e nxjerra nga 6 fokus grupe të organizuara në mbarë Kosovën më 2017 e 2018. Fokus-grupet ishin mostra të komuniteteve lokale, udhëheqësve fetarë dhe qytetarëve që ofronin perspektivat e tyre për ekstremizmin dhe terrorizmin e dhunshëm. Gjetjet e Barometrit të Sigurisë së Kosovës (BKS), që masin besimin e publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe kërcënimeve si ekstremizmi i dhunshëm, radikalizimi dhe terrorizmi, gjithashtu u përfshinë në raport, duke mundësuar që autori të kryejë një analizë ndërsektoriale të të dhënave.

HYRJJE

Që nga fillimi i 2016-ës, një sërë kundërmasash të bashkërenditura dhe operacionesh ushtarake të ndërmarra kundër Shtetit Islamik të Sirisë dhe Irakut (ISIS) arritën ta mposhtnin këtë formacion terrorist. Për shkak të humbjeve në territor dhe njerëz, fuksi i LHT-ve në arenat e konfliktit në Irak e Siri u ul dukshëm deri në pikën e humbjes totale të saj.² Me fillimin e 2018, ISIS pothuajse se humbi kontrollin e territorit që mbante në këto dy vende.³ Por tkurrja e IS shkaktoi panik në Evropë dhe gjetiu në pritje të “vërshimit” prej të kthyerve nëpër vendlindjet e tyre. Megjithatë, pavarësisht prej këtyre shqetësimeve, shumë vende në fakt vetëm një numër të vogël është kthyer vendlindjet e tyre.⁴ Luftëtarët e huaj që mbeten në zonat e konfliktit kanë gjasë t’i mbeten besnikë ideologjisë së IS dhe do të hezitojnë të kthehen nëpër vendlindjet e tyre.⁵

Në rastin e Kosovës, dy janë faktorët kryesorë që shpjegojnë kthimin e ngadalshëm të luftëtarëve të huaj dhe të familjeve të tyre: besnikëria e luftëtarëve të huaj ndaj IS dhe ngurrimi i Turqisë që t’i lejojë anëtarët e IS-së të hyjnë në territorin e saj. Diku 190 qytetar ende mbeten në Siri e Irak, ose rreth gjysma e atyre që iu bashkuan IS-it dhe organizatave të tjera terroriste që nga viti 2012. Shumica dërmuese e atyre që udhëtuan nga Kosova për në territorin e mbajtur nga IS, shkuan nëpërmjet Turqisë.

Mposhtja fizike e IS rezultoi me ndryshim të strategjisë së tij operative, duke i bërë shtetet t’i rishikojnë dhe t’i përshtasin vazhdimisht politikat e sigurisë dhe kornizën ligjore për t’iu përgjigjur natyrës gjithnjë të ndryshueshme të kanosjes që shfaq organizata terroriste dhe rrjeti i simpatizantëve të saj.

2 Dempsey, M.P. (2017) “The Caliphate Is Destroyed, But the Islamic State Lives On” *Foreign Policy*, gjendet në <http://foreignpolicy.com/2017/11/22/the-caliphate-is-destroyed-but-the-islamic-state-lives-on/> (qasja më 19 gusht 2018).

3 Byman, D.L. (2018) “What happens when ISIS goes underground?” *Brooking Institute*, gjendet në <https://www.brookings.edu/blog/markaz/2018/01/18/what-happens-when-isis-goes-underground/> (qasja më 19 gusht 2018).

4 Po aty:

5 Intervistë me ekspert kosovar për terrorizmin. (maj 2018) Prishtinë

Për shkak të natyrës globale të kërcënimit të IS, ka trende në zhvillim që nuk ishin të zakonshme në përvojat e mëparshme me terrorizmin. Numri i shtuar i sulmeve vetëvrasëse dhe i rasteve të terrorizmit të përhapur përbrenda janë disa nga shenjat që tregojnë se ISIS kanë ndërruar natyrën e tyre të veprimit dhe taktikat.

Ndryshimet në dinamikën e terrorizmit ndërkombëtar kanë pasoja për gjithë Evropën, por ato rrezikojnë ta ndikojnë thellësisht edhe në Ballkanin Perëndimor dhe veçmas Kosovën, rajon ky që ende është në procesin e reformimit të sektorit të vet të sigurisë.

Politikëbërësit e Kosovës po ballafaqohen me kërcënimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) për të gjashtin vit me radhë. Kohët e fundit ata e kanë zhvendosur fokusin e tyre në programet e riintegrit të luftëtarëve të huaj të kthyer, të cilët, pasi shumë viteve në organizata terroriste, kanë sjellë në Kosovë një pikëpamje ekstreme ideologjike, përvojë luftarake dhe një rrjetëzim të luftëtarëve të huaj nga pjesë të tjera të Evropës.⁶

Deri tash, sipas të dhënave të disponueshme që tregojnë angazhimin e LHT-ve të kthyer në komplete terroriste, kanosja prej luftëtarëve të huaj të kthyer, pavarësisht numrit të lartë të tyre, “mbetet shumë e ulët”,⁷ siç vlerësohet nga përfshirja dhe pjesëmarrja e tyre në komplete të tentuara terroriste dhe incidente të parandaluara në Kosovë në dy vitet e fundit.

Nga 135 të kthyer, pesë kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në aktivitete të lidhura me raste të terrorizmit. Vlenë të përmendet rasti i nëntorit 2016, kur autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë arrestuan mbi njëzet individë të dyshuar për planifikimin e sulmeve të njëkohshme terroriste në Kosovë e Shqipëri gjatë ndeshjes kualifikuese të Kupës Botërore 2018 midis Shqipërisë dhe Izraelit. Thuhet se sulmin e kishin urdhëruar ish-udhëheqësit e ISIS për Kosovën, Ridvan Haqifi dhe Lavdrim Muhaxheri, të dy tashmë të vdekur nga sulmet ajrore të ShBA në Siri.⁸ Në një incident tjetër të lidhur me IS, dy luftëtarë të huaj të kthyer në Kosovë u arrestuan pranë njërit nga rezervuarët më të mëdhenj të ujit në vend, duke regjistruar një video propagandistike të IS për t'i joshur të rekrutuarit e Kosovës që t'i bashkohen organizatës terroriste.⁹

6 “Ramush Haradinaj: Kosova e gatshme ti riatdhesej te kthyerit nga Siria” (2017) gjendet në <https://telegrafi.com/ramush-haradinaj-kosova-e-gatshme-ti-riatdheseje-luftetaret-e-sirise/> (qasja më 18 gusht 2018).

7 Stati

8 Kursani, Sh. (2017) “Kosovo Risk assessment report since independence - February 2008 - June 2017” QKSS gjendet në http://www.qkss.org/repository/docs/KS-RiskAssessment-eng_201377.pdf

9 Po aty:

Siç deshmojnë studime të ndryshme, si “Terrorizmi dher Ujqit e Vetmuar: të kuptuarit e kërcënimit në rritje” me autor Jeffrey D. Simon, simpatizantët, ideologët ose sulmuesit që nihen si “ujqit e vetmuar”, të cilët nuk i janë bashkuar kurrë fizikisht IS-it, mbeten kërcënim më i lartë sesa ish-luftëtarët e huaj të këtij formacioni.¹⁰ Këto gjetje përkojnë me vrojtimet e bëra në Kosovë për qëllimet e këtij studimi. Për shembull, vetëm dy nga 22 individë të dyshuar për sulmin e tentuar kundër ekipit kombëtar izraelit ishin anëtarë të IS, ndërsa pjesa tjetër kurrë nuk ka udhëtuar në Siri a Irak si pjesë e IS ose e ndonjë organizate tjetër terroriste. Kjo lloj gjetjeje i sfidon edhe më shumë aktivitetet e institucioneve të sigurisë në Kosovë. Çështja ka gjasa të dalë si kërcënim më i madh i sigurisë kombëtare në rajon pas rënies së IS në Siri, dhe agjencitë e zbatimit të ligjit do të ngarkohen jo vetëm të parandalojnë dhe luftojnë terrorizmin e përhapur nga brenda edhe t’i monitorojnë mbështetësit dhe simpatizantët, dhë në të njëjtën kohë përveçse që do të mbajnë nën mbikëqyrje luftëtarët e huaj kthyer në vendlindjet e tyre.

Në këtë linjë, qëllimi i këtij raporti është të identifikojë tendencat dhe kërcënimet e reja të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë pas mposhtjes së IS-it. Sfidat e identifikuara në raport janë rastet e terrorizmit vendas, të ashtuquajturve “ujq të vetmuar”,¹¹ të komuniteteve të cënueshme, të riintegritit të ish-luftëtarëve të kthyer dhe të familjeve të tyre.

Pjesa e parë e raportit përbëhet nga një analizë e kontekstit ndërkombëtar të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, duke përfshirë mposhtjen e IS dhe ndryshimin e strategjisë së IS. Kjo pjesë e raportit kontekstualizon rrezikun që përbëjnë luftëtarët e huaj të kthyer, simpatizantëve dhe mbështetësve të terrorizmit si dhe rrjetet ndërkombëtare të terrorizmit.

Pjesa e dytë e raportit fokusohet në ekstremizmin e dhunshëm në Ballkanin Perëndimor dhe në Kosovë si dhe në përpjekjet e autoriteteve vendore për ta luftuar këtë rrezik.

Pjesa e tretë e raportit identifikon kërcënimet e reja të ekstremizmit të dhunshëm dhe të terrorizmit në Kosovë në përpjekje për t’i nxitur autoritetet dhe publikun përgjithësisht që ta diskutojnë natyrën e evolucionit të kërcënimit e ekstremizmit të dhunshëm.

10 “Lone Wolf Terrorism: Understanding the Growing Threat Paperback” me autor Jeffrey D. Simon. 27 shtator 2016

11 Bennett, B.B. (2007) “Understanding, Assessing, and Responding to Terrorism: Protecting Critical Infrastructure and Personnel”. Sipas tij **“Terrorizmi ujkut vetmitar përfshin ekstremistë individualë që zakonisht veprojnë vetëm dhe nuk janë pjesë e ndonjë organizate ose formimi terrorist ose në margjinat e grupeve ekstremiste të njohura, duke shkaktuar dëm serioz ose duke shkaktuar dëmtime të konsiderueshme.”**

KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR PAS MPOSHTJES SË ISIS

Evolucioni i IS nga një degë e al-Kaidës në njërën prej organizatave terroriste më të fuqishme në botë e ka kthyer këtë formacion në një brend globale terrorizmit.¹² Megjithatë, mposhtja fizike e saj pas gati gjysmë dekadë të ekzistencës ka krijuar një mjedis të ri sigurie dhe kërcënime të reja të terrorizmit.¹³ Mungesa e kontrollit të IS mbi territorin ka çuar në rritje të pranisë së saj në sferën virtuale që vazhdon të ndikojë ideologjikisht dhe të afektoj individë që nuk kanë pasur mundësi t'i bashkohen "Kalifatit", për t'i çuar tutje qëllimet e IS-së me mjete të tjera. Kyjolloj strategjie ka afektuar shumë sulmues të njohur si "ujq të vetmuar" dhe simpatizantë të IS-it në mbarë botën, që mund të ndër marrin sulme, duke u bazuar në qëllimet e IS-së dhe në përputhje me ideologjinë e saj.¹⁴

Aftësia e IS-së që të frymëzojë sulme e vështirëson luftimin e saj dhe shkatërrimin e plotë të saj për të kryer akte terrorizmi. Lirija e madhe e veprimit të antarëve të këtij formacioni terrorist mundëson cilitdo individ që të aspirojë që ta mendoj veten si anëtar i IS, pa pasur kurrfarë kontakti fizik me organizatën. Zhvendosja e strategjisë së IS e ka bërë gjithnjë e më sfiduese përballjen e autoriteteve shtetërore me të.¹⁵ Siç pohon Marc Sageman në raportin e tij "Të kuptuarit e rrjetit të terrorit", "terrorizmi sot është kryesisht nismë e vetëgjeneruar nga poshtë-lart, e vetorganizueshme dhe locale, që ka fleksibilitet të konsiderueshëm». Taktika e decentralizimit, e përdorur më parë nga al-Kaida, e që tash po përdoret nka veprimtaria e IS-it,¹⁶ u ofron antarëve dhe simpatizantëve të vet një nivel sekreti në kryerjen e aktiviteteve terroriste dhe fleksibilitet për t'i ndërmarrë ato.¹⁷

12 "ISIS's New Frontier: Combating Decentralization, Defeat and Despair" (2017) gjendet në <https://www.adl.org/blog/isis-new-frontier-combating-decentralization-defeat-and-despair> (qasja më 19 gusht 2018).

13 Po aty:

14 McCants, W. (2017) "After the fall of ISIS, what's next for counterterrorism? Experts discuss" *Brooking.edu* gjendet në <https://www.brookings.edu/blog/markaz/2017/10/03/after-the-fall-of-isis-whats-next-for-counterterrorism-experts-discuss/>

15 Sageman, M. "Understanding terror network" <https://wew.aclu.org/files/fbimappingfoia/20111110/ACLURM002083.pdf>

16 "ISIS's New Frontier: Combating Decentralization, Defeat and Despair" (2017) gjendet në <https://www.adl.org/blog/isis-new-frontier-combating-decentralization-defeat-and-despair>

17 Po aty:

Në filltet e veta, "Kalifati" tërhoqi shumë luftëtarë të huaj drejt Sirisë dhe Irakut për t'iu bashkuar përpjekjeve për ta krijuar të ashtuquajturin "Shtet Islamik". Që nga viti 2012 e deri tash mbi 20,000 (njëzet mijë) individë nga e gjithë bota janë bashkuar me IS-in. Imazhi utopik i një jete në "Kalifat" ishte njëri ndër faktorët kryesorë tërheqës.¹⁸ Sipas familjeve të luftëtarëve të huaj që i ndoqën këta në Siri, thane se në fillim jeta në "Kalifat" ishte e mirë dhe individët që jetonin atje ndjenin se e kishin arritur ëndrrën për të jetuar në një shtet ku mund ta ushtronin lirisht fenë dhe t'i rrisnin fëmijët në një vend dhe shoqëri të përkryer.¹⁹

Gjatë kësaj periudhe, për shkak të kontrollit të puseve të naftës dhe tregtisë së paligjshme, IS kishte fuqi financiare, ushqim dhe armë dhe ishte superiore ndaj grupeve të tjera të armatosura aktive asokohe, përfshirë këtu Armatën e Sirisë së Lirë (ASL), Al Fateh al Sham (dikur Jabhat al Nusra) Ahrar al Sham dhe të tjera.²⁰ Për shkak të kontrollit dhe fuqisë fillestare, IS arriti të tërhiqte një numër të luftëtarëve për t'i kryer luftimet në emër të saj dhe më vonë për të projektuar besueshmërinë duke krijuar një vend për të jetuar.²¹ Synimi i IS-së për të dalë si organizatë udhëheqëse në krijimin e "Kalifatit" dhe mbrojtjen e Islamit rezultoi me përplasjet mes IS-së dhe organizatave të tjera rebele në Siri dhe më vonë në Irak. Për ta dominuar "Luftën e Shenjtë" dhe për ta përvetësuar "Xhihadin"²², IS iu vu kundërvë të rivalëve, duke sulmuar fillimisht Ushtrinë e Sirisë së Lirë (ASL) dhe pastaj organizatat e tjera terroriste si Jabha Al Nusra, grup militant kryesisht sunit. Përplasjet mes ISIS dhe forcave të tjera opozitare e zhgënjyen një pjesë të luftëtarëve të huaj nga IS, por nuk i nxitën që ta braktisnin ideologjinë ose vendimin për të marrë pjesë në konflikt.²³

Pas sulmeve ajrore të udhëhequra nga ShBA kundër IS, organizata pësoi humbje të mëdha, duke përfshirë kontrollin mbi pjesë të mëdha të territorit dhe të burimeve financiare. Mposhtja ushtarake e IS-së i bëri shumë luftëtarë të huaj të ndjenin zhgënjim për vendimin për t'iu bashkuar organizatës terroriste, sikurse edhe trajtimi që u bënte civilëve nën kontrollin e saj. Sipas një luftëtari irakian të IS «qëllimi ynë ishte me qenë besimtarë të vërtetë; ndershmëria dhe besnikëria ndaj Allahut ishin

18 The Soufan Group (2015) FOREIGN FIGHTERS THE SOUFAN GROUP DECEMBER 2015 JUNE 2014 An Updated Assessment of the Flow of Foreign Fighters into Syria and Iraq (2015) *The Soufan Group* http://soufangroup.com/wp-content/uploads/2015/12/TSG_ForeignFightersUpdate3.pdf

19 Intervistë me një të kthyer nga konflikti në Siri. Shtator 2017

20 Po aty;

21 Intervistë me një të kthyer nga konflikti në Siri. Shtator 2017

22 Jones, S.G., Dobbins, J., Byman, D., Chivvis, C.S., Connable, B., Martini, J., Robinson, E., Chandler, N. (2017) Rolling Back the Islamic State https://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/research_reports/RR1900/RR1912/RAND_RR1912.pdf

23 Të dhëna ofruar mediave në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, dhe BeH nga agjencitë e zbatimit të ligjit.

disa nga vlerat që duhej t'i shpallin Kalifati dhe organizata. Megjithatë, gjetëm diçka tjetër²⁴. Sipas tij, vrasja masive e civilëve, përdhunimi i grave shiite, të krishtera dhe jazidi ishin akti iniciues dhe dëshmia e zotimit dhe besnikërisë së luftëtarëve ndaj "Kalifatit".²⁵

Ndryshimi i dinamikave të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në nivel ndërkombëtar rezultoi edhe me ndryshimin e strategjisë së përgjithshme të IS. Kanë kaluar ditët kur Kalifi i vetëshpallur, Ebu Bekr al-Baghdadi, u bënte thirrje myslimanëve anembanë botës që t'i braktisin "vendlindjet e tyre dekadente" dhe të shpërnguleshin në Shtetin Islamik.²⁶ Në tri vitet e fundit, liderët e këtij grupi u thonë ndjekësve të qëndrojnë ku janë dhe t'i luftojnë «të pafetë», «aty ku u dhemb më së shumti».²⁷ Kryerja e sulmeve terroriste për anëtarët dhe simpatizantët e IS tani është më shumë detyrë sesa ide.²⁸

Ky ndryshim i ka shtuar kërcënimet dhe mundësitë e kompleteve dhe sulmeve nëpër Evropë, nga vijnë shumica e luftëtarëve të huaj që iu bashkuan IS-së. Në linjë me strategjinë e re, IS e ka hedhur rrjetën e vet më gjerë, duke shpallur se kushdo mund të jetë ushtar i «Kalifatit», pa pasur nevojë të udhëtojë në Siri ose Irak ose të ketë marrëdhënie formale me organizatën. Sipas qasjes së re të IS, simpatizuesit e IS mund të kryejnë "xihadin" me anë të sulmeve kundër shteteve të tyre për të vrarë civilë, autoritete shtetërore dhe të tjerë që dalin kundër ideologjisë së IS.²⁹ Kjo qasje rezultoi në goditje sulmesh dhe komplotesh terroriste në Evropë në tri vitet e fundit.

Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar u vranë 22 persona dhe 118 u plagosën në një sulm vetëvrasës në Manchester Arena në qershor 2017.³⁰ Sulmuesi ishte i vetëm, i cili kurrë s'kishte qenë anëtar i IS, por ishte frymëzuar shumë nga ideologjia e këtij grupi. Sulmet e tjera terroriste të kryera nga "ujqit e vetmuar" gjatë kësaj periudhe u kryen në Belgjikë, Gjermani, Turqi, Francë dhe gjetiu.

24 Cockburn, P. (2015) "Life under Isis: Why I deserted the 'Islamic State' rather than take part in executions, beheadings and rape - the story of a former jihadi" gjendet në <https://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/life-under-isis-why-i-deserted-the-islamic-state-rather-than-take-part-in-executions-beheadings-and-10111877.html>

25 Po aty;

26 "Isis leader calls on Muslims to 'build Islamic state'" (2014) gjendet në <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-28116846>

27 Po aty;

28 Po aty;

29 Për më shumë, shih artikullin: <https://www.theguardian.com/commentisfree/2017/dec/31/isis-dreams-of-caliphate-gone-now-deadly-new-strategy>

30 "Manchester Attack - wëhat we know so far?" (2017) <https://www.bbc.com/news/uk-england-manchester-40008389>

Veç kësaj, simpatizuesit e rinj kanë më shumë potencial dhe aftësi për të ndërmarrë sulme terroriste krahasuar me luftëtarët e huaj të kthyer. Në 4 vitet e fundit më pak se 1/5 e sulmeve të motivuara fetarisht nëpër Evropë ishin vepra të ish-luftëtarëve të huaj, ndërsa pjesa tjetër ishin nga simpatizantë ose sulmues “ujq të vetmuar”.³¹ Vetëm një pjesë e vogël e luftëtarëve të huaj të kthyer ka potencialin për t’u përfshirë në aktivitetet e terrorizmit në të ardhmen nëpër Evropë e gjetiu.³² Njëri nga faktorët kryesorë, që mund ta parandalojë përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë në komplete terroriste, është mbikëqyrja e madhe e tyre nga autoritetet shtetërore. Të kthyerit, megjithatë, mund ta përdorin përvojën e vet, përfojnë luftarake dhe organizative për krijimin e gjeneratave të reja të “xhihadistëve” duke i trajnuar ata, duke e përhapur ideologjinë dhe duke i zhvilluar aftësitë e tyre në planifikimin e sulmeve dhe përgaditjen e eksplozivëve për të kryer akte terroriste.³³

Përgjithësisht, të kthyerit duket se kontrollohen më lehtë nga autoritetet shtetërore sesa simpatizuesit e ISIS të cilët vështirë identifikohen para se të kalojnë në veprim. Ky vlerësim u nda kohët e fundit nga autoritetet franceze që pretendojnë se, i inkurajuar e i drejtuar nga të kthyerit ose jo, kërcënimi i brendshëm terrorist nga mbështetësit e IS që nuk kanë shkuar në Siri, Irak ose në front tjetër të IS, do të mbeten kërcënim i madh për shumë vjet.

Me gjithë këto, ka dëshmi të shtuara se të kthyerit do të luajnë rol vendimtar në nxitjen e sulmeve terroriste në truallin e Evropës, sipas udhëzimeve të strategjisë së IS. Roli i tyre duket qendror në planifikimin dhe përgatitjen e çdo sulmi terrorist të shkallës së lartë. Nuk mund të jetë rastësi që operacioni më shkatërrues i Shtetit Islamik në Evropë - sulmet e nëntorit 2015 në Paris që vranë 137 vetë - ishin planifikuar dhe ekzekutuar nga një ekip i të kthyerve që ishin trajnuar për të ndërmarrë kësi lloj sulmesh, që IS shpreson të bëhen shenjë dalluese e strategjisë së vet të re të shpërndarjes së frikës dhe terrorit, duke i siguruar organizatës monopol në terrorizëm. Ndërkohë që nami sipërfaqësor i “markës” së Shtetit Islamik vazhdon të zbehet, ka gjasë që anëtarët më me përvojë dhe ideologjikisht më të angazhuar të organizatës terroriste do të luajnë rol më të madh.³⁴

31 Po aty:

32 Po aty:

33 Po aty:

34 Po aty:

KONTEKSTI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË

Konfliktet e zgjatura në Siri e Irak dhe përhapja e shpejtë e organizatave terroriste si Shteti Islamik i Sirisë e Irakut (ISIS) dhe El Fatih el Sham (ish-Fronti el-Nusra) joshën shumë individë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor për t'u bashkuar me këto grupe militante. Që nga viti 2012, rreth 850 deri në 1000 individë nga Bosnja, Kosova, Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria kanë udhëtuar në Siri/Irak si luftëtarë të huaj. Ky numër i përgjithshëm përfshin gratë dhe fëmijët që përgjithësisht nuk konsiderohen luftëtarë, por figurojnë në të dhënat zyrtare si pjesëmarrës në konflikt.³⁵

Fenomeni i luftëtarëve të huaj është kërcënim në rritje që paraqet sfida afatgjatë për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Që nga viti 2012, rreth 403 persona³⁶ udhëtuan nga Kosova për t'u bashkuar me organizatat terroriste në Siri e Irak. Nga ky total, 255 janë luftëtarë të huaj, ndërsa pjesa tjetër janë gra dhe fëmijë.³⁷ Bazuar në të dhënat e ofruara nga autoritetet, rreth 40 fëmijë kanë lindur në konflikt nga të paktën njëri prind me prejardhje prej Kosovës. Rreth 135 individë janë kthyer në Kosovë dhe po gjykohe në gjykatat vendore. Rreth 75 luftëtarë të huaj të Kosovës raportohen të vrarë, ndërsa rreth 190 individë vlerësohet të kenë mbetur në zona konflikti.³⁸

35 The Soufran Group (2015) FOREIGN FIGHTERS THE SOUFAN GROUP DECEMBER 2015 JUNE 2014 An Updated Assessment of the Flow of Foreign Fighters into Syria and Iraq (2015) *The Soufran Group* http://soufangroup.com/wp-content/uploads/2015/12/TSG_ForeignFightersUpdate3.pdf

36 Të dhëna zyrtare ofruar autorit, janar 2018

37 Po aty;

38 Po aty:

Gjatë vitit 2013 dhe në pjesën e parë të vitit 2014



294 individë nga Kosova
shkuan në Siri dhe Irak

Nga viti 2015 deri më tani



82 individë nga Kosova
shkuan në Siri dhe Irak



Numri i personave kosovarë që kanë udhëtuar në Siri e Irak sipas komunave


DUKURIA E LUFTETARIT TË HUAJ TË KOSOVËS

Udhëtimi i luftëtarëve të huaj nga Kosova arriti kulmin gjatë vitit 2013 dhe gjysmës së parë të vitit 2014, periudhë kjo kur IS sapo kishte nisur të konsolidohej si organizatë terroriste. Sipas të dhënave zytare, gjithsej 294 persona nga Kosova kanë udhëtuar në Siri e Irak gjatë kësaj kohe.³⁹ Të tjerët, 82 persona nga Kosova, kanë udhëtuar në Siri e Irak nga 2015 e tutje, duke shënuar rënie të dukshme në numrin e personave kosovarë që udhëtonin në këto zona luftime.⁴⁰

Ndonëse mund të ketë faktorë të ndryshëm që diktojnë rënien e ndjeshme në fluksin e luftëtarëve të huaj, ky raport ka identifikuar pesë arsye kryesore që çuan në këtë ndryshim peizazhi: zhgënjimi nga IS ndërsa i luftonte rivalët e vet në Siri, thirrjet e vazhdueshme nga familjet të luftëtarëve të huaj në Kosovë për t'u kthyer, zvogëlimi i kontrollit të territorit nga ana e IS për shkak të disfatave ushtarake dhe përpjekjeve të zbatuesve të ligjit në Kosovë për ta luftuar ekstremizmin e dhunshëm në terren dhe për ta parandaluar largimin e qytetarëve të vet në Siri.


39 Të dhënat e Policisë së Kosovës ofruar autorit, janar 2018.

40 Po aty:



Udhëtime LH kosovarë në Siri e Irak sipas viteve⁴¹

Në periudhën midis 2012 dhe 2013 rreth 135 qytetarë të Kosovës u kthyen nga konflikti në Siri. Kjo periudhë përkon me ngritjen e “Kalifatit” dhe përplasjet mes IS dhe grupeve të tjera rivale islamike, të cilat atëherë ishin aktive në Siri e Irak.



Luftëtarët e huaj të kthyer në Kosovë sipas viteve⁴²

41 Po aty:

42 Të dhënat e Policisë së Kosovës ofruar autorit, janar 2018.

FAMILJET KOSOVARE QË UDHËTUAN NË SIRI E IRAK

Përveç luftëtarëve të huaj, një numër i madh i familjeve kanë ndjekur baballarët dhe bashkëshortët në territorin e kontrolluar prej IS-së. Rreth 143 familje⁴³ nga Kosova kanë udhëtuar në Siri e Irak. Në shumicën e rasteve udhëtimi i tyre është iniciuar ose imponuar nga kryefamiljari. Ka arsye të ndryshme të cituara nga familjet e luftëtarëve të huaj nga Kosova për vendimin që të udhëtojnë në zonat e luftës, duke filluar nga gatishmëria për të jetuar sipas rregullave të "Shtetit Islamik" deri te mungesa e alternativave në Kosovë, si dhe marrëdhëniet e fuqisë gjinore që lidhen me shoqërinë patriarkale në Kosovë.



Numri i familjeve kosovare që udhëtuan në territorin e mbajtur nga IS sipas komunës⁴⁴

⁴³ Po aty:

⁴⁴ Të dhënat e Policisë së Kosovës ofruar autorit

Tërheqja ndaj utopisë së premtuar publikut në Kosovë nga përfaqësuesit e Shtetit Islamik ishte njëri nga faktorët kyçë joshës që i nxiti këta persona të kërkonin ta çonin jetën në “Kalifat”, të udhëhequr nga besimi se do të kontribuonin në krijimin e “shoqërisë së përkryer”. Sic tha nëna e një luftëtari të huaj nga rajoni i Gjilanit⁴⁵ kohët e fundit: “Djali im ishte student shumë i mirë në Prishtinë dhe kurrë nuk hasi në ndonjë dhunë këtu në rajonin e Gjilanit a në Prishtinë. Pasi u themelua Kalifati, vendosi të shkonte ta praktikonte fenë lirshëm, dhe të jetontë, pa paragjykimin e të tjerëve”.

Një faktor shtesë ishte mungesa e përkrahjes nga mekanizmi shtetëror për t’i parandaluar gratë që të udhëtojnë në zona lufte në Lindjen e Mesme. Për më shumë, disa nga gratë e përfshira shpesh nuk janë në dijeni të instrumenteve shtetërore që kanë në dispozicion për mbrojtjen e tyre dhe në përgjithësi nuk kanë guxim ta raportojnë presionin e ushtruar ndaj tyre nga burrat.⁴⁶ Ka dy arsye kryesore që shpjegojnë këtë sjellje: së pari, mungesa e besimit në institucionet shtetërore për t’i trajtuar çështjet e tilla dhe së dyti, ato ngurrojnë t’ua raportojnë këto raste autoriteteve për shkak të shqetësimeve për sigurinë e tyre personale.⁴⁷

Vetizolimi i familjeve të luftëtarëve të huaj nga pjesa tjetër e komunitetit është njëri nga faktorët që i bën këto familje më të prekura nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm.⁴⁸ Disa nga familjet që udhëtuan në Lindjen e Mesme kishin pikëpamje radikale fetare dhe i konsideronin ata që nuk ndanin të njëjtat vlera si jobesimtarë. Këto familje thanë se ndjenin që nuk mund ta ushtronin lirisht fenë në një shoqëri laike të Kosovës dhe se e shihnin “Kalifatin” si alternativë të shëndetshme.⁴⁹

Komunitetet në Kosovë ishin të rezervuara dhe shmangeshin nga ndërveprimi me familjet konservative të luftëtarëve të huaj për shkak të mënyrës së praktikimit të fesë prej tyre. Megjithatë, ky raport gjeti se në shumë raste izolimi i familjeve radikale të luftëtarëve të huaj ishte i vetëshkaktuar dhe më pak vinte prej stigmatizimit nga komuniteti ku jetojnë. Për shembull, një familje nga Mitrovica pranoi se nuk kishte marrëdhënie me komunitetin ku jeton dhe se nuk kërkon “asnjë kontakt me fqinjët dhe komunitetin për shkak të fesë”⁵⁰

45 Intervistë me familjen e LH nga Vitia, nëntor 2017

46 Intervistë me nënën e grave nga Podujeva që ndodhen në Siri dhe Irak. shkurt 2018

47 Po aty;

48 Intervistë me familjen e LH nga Mitrovica, dhjetor 2017, dhe intervistë me LH nga Prizreni, janar 2018

49 Po aty;

50 Intervistë me prindin e LH nga Mitrovica, 20 nëntor 2017

Perceptimi i familjeve ishte se autoritetet dhe komuniteti i paragjykojnë për shkak të orientimit fetar, duke i bërë të ndihen të tjetërsuar nga komuniteti dhe autoritetet.⁵¹ Këto pikëpamje dhe perceptimet e izolimit, qoftë të vetimponuara, të imagjinuara a reale, duket se i bëjnë familjet radikale fetare në Kosovë më të prekura nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm.


Para krijimit të «Kalifatit» në korrik 2014, vetëm 15 familje të Kosovës udhëtuan për në Siri e Irak. Pas shpalljes së «Kalifatit», midis viteve 2014 e 2015, rreth 108 familje të luftëtarëve të huaj u shpërngulën në territorin e kontrolluar nga IS me shpresën e vendosjes në «Kalifat», meqë po lulëzonte ekonomikisht, financiarisht dhe ushtarakisht.⁵²

Më 2016 dhe 2017 vetëm katër familje të luftëtarëve të huaj nga Kosova udhëtuan për në Siri dhe Irak. Ndër faktorët që kontribuan në uljen e numrit të familjeve që udhëtonin në territorin e IS ishte mposhtja e ISIS, rritja e kontrollit të kufijve të Kosovës dhe zhgënjimi i luftëtarëve të huaj me IS.⁵³

51 Po aty:

52 Të dhënat e Policisë së Kosovës ofruar autorit, janar 2018.

53 Të dhënat e Policisë së Kosovës ofruar autorit, janar 2018



Familjet e LH që udhëtuan në Siri/Irak përgjatë viteve⁵⁴

54 Të dhënat e Policisë së Kosovës ofruar autorit, janar 2018. Intervistë me LH të kthyer nga Ferizaji, tetor 2018.

BOMBË E KURDISUR: LUFTËTARËT E HUAJ TË KTHYER DHE SIMPATIZANTËT E IS NË KOSOVË?

Në Evropë, rreth 1 në 360 të kthyer, kanë qenë të përfshirë ose kanë planifikuar një sulm pas kthimit të tyre nga luftimet përkrah IS (Shtetit Islamik) dhe organizatave të tjera terroriste.⁵⁵ Pjesa më madhe e sulmeve terroriste në nivel ndërkombëtar janë kryer nga simpatizantë apo njerëz të lidhur ideologjikisht me IS, pa qenë fizikisht pjesë të tij.

Simpatizantët e IS u përfshinë në disa nga sulmet më të spikatura në Evropë: në sulmin e Nicës, në korrik 2016, në sulmet në qytetet gjermane Ansbach dhe Würzburg, gjatë të njëjtit muaj (korrik 2016), në sulmin në Tregun e Krishtlindjeve në Berlin, dhjetor 2016, dhe në sulmin në Parlamentin në Londër, mars 2017. Këto sulme janë shembuj që ilustrjnë më së miri kërcënimin e fuqishëm që paraqesin simpatizantët në Evropë, të cilët nuk kanë promovuar një marrëdhënie me organizatën terroriste.⁵⁶

Deri më sot, në Kosovë nuk ka pasur sulme terroriste. Luftëtarët e huaj të kthyer kanë qenë të përfshirë në planifikimin e kompleteve terroriste, por autoritetet e Kosovës kanë parandaluar realizimin e këtyre planeve.⁵⁷ Sipas databazës sonë, nga 135 luftëtarët e huaj të kthyer, 5 janë përfshirë në komplete terroriste, ose një në njëzet e pesë të kthyer, një shkallë e përhapjes shumë më e lartë se mesatarja evropiane.⁵⁸ Megjithatë, ky raport sugjeron që simpatizuesit e IS ose terroristët vendorë do të paraqesin një kërcënim imediat më të madh për sigurinë kombëtare sesa luftëtarët e huaj të kthyer, të cilët tashmë janë identifikuar nga autoritetet dhe aktivitetet e të cilëve shpesh monitorohen.


⁵⁵ [ibid.](#)

⁵⁶ Reed, A., Pohl, J., Jegering, M. (2017) "The Four Dimensions of the Foreign Fighter Threat: Making Sense of an Evolving Phenomenon" <https://icct.nl/wp-content/uploads/2017/06/ICCT-Reed-Pohl-The-Four-Dimensions-of-the-Foreign-Fighters-Threat-June-2017.pdf>

⁵⁷ Databaza e QKSS mbi kanosjet terroriste në Kosovë që nga pavarësimi, janar 2018

⁵⁸ Kursani, Sh. (2017) "KOSOVO RISK ASSESSMENT REPORT SINCE INDEPENDENCE FEBRUARY 2008 – JUNE 2017" QKSS, http://www.qkss.org/repository/docs/KS-RiskAssessment-eng_201377.pdf

135 luftëtarë të kthyer, 5 u përfshinë në komplete terroriste



Një nga faktorët kryesorë që merren parasysh për pjesëmarrjen relativisht të ultë të ish luftëtarëve të huaj në komplotet terroriste në vend, duket të jetë pendimi i tyre që i ishin bashkuar IS dhe që ishin pajtuar me ideologjinë e tij. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre e ultë mund të jetë gjithashtu një fryt i përpjekjeve të autoriteteve të sigurisë të Kosovës, të cilët në mesin e vitit 2014 vepruan shpejt për të kapur pjesën dërrmuese të atyre që po ktheheshin nga Shteti Islamik dhe për t'i vënë nën vëzhgim të afërt që nga atëherë⁵⁹ Përveç kësaj, luftëtarët e huaj të kthyer dhe sfida e tyre për riintegrim ofrojnë një rrëfenjë paralajmëruese për të gjitha vendet evropiane që janë prekur nga ky fenomen. Siç tregon rasti studimor në Kosovë, luftëtarët e huaj të kthyer janë përfshirë në disa raste, duke shtuar njohuritë e veta dhe duke shfrytëzuar rrjetin e tyre për të arritur qëllimet e IS, megjithëse përmes taktikave të ndryshme. Ekzistojnë dy raste terroriste ku janë përfshirë luftëtarët e huaj të kthyer. Në një rast të tillë, të njohur si “Rasti i Izraelit”, Policia e Kosovës kishte arrestuar 22 individë të dyshuar për planifikim të sulmit ndaj ekipit kombëtar të futbollit të Izraelit, gjatë një ndeshjeje kualifikuese për Kupën Botërore, e cila u zhvillua në Shqipërinë fqinje. Nga 22 të dyshuarit, një ishte luftëtar i huaj i kthyer nga IS. Pjesa tjetër ishin simpatizantë.

Në rastin e dytë, të njohur si “Rasti i Badovcit,” policia kishte arrestuar 5 individë pasi ata po filmnin një video propagandistike të IS, e cila synonte audiencën e Kosovës. Dy nga të dyshuarit, ishin luftëtarë të huaj të kthyer. Ngjashëm, në komplotin e tretë terrorist, i cili u pengua nga Policia e Kosovës më 2013 në Prishtinë dhe në qytetin juglindor të Gjilanit, nga shtatë të dyshuarit e arrestuar nga policia, dy ishin luftëtarë të huaj të kthyer.⁶⁰

59 Po aty:

60 Po aty:

Shumica e luftëtarëve të huaj të kthyer në Kosovë, të cilët morën pjesë në luftimet në Siri dhe Irak, iu nënshtruan gjyqeve në gjykatat e Kosovës. Ata kanë refuzuar të pranojnë fajësinë dhe, në vend të kësaj, kanë kritikuar autoritetet shtetërore dhe punën e tyre kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në Kosovë, si paragjykim ndaj myslimanëve të devotshëm.⁶¹ Mungesa e pendimit dhe keqardhjes për pjesëmarrjen e tyre në një organizatë terroriste, është ndoshta treguesi më i dukshëm se këta individë janë ende përkrahës të ideologjisë së dhunshme të ekstremizmit, duke thëlluar kështu shqetësimet se ata mund të çojnë më tej përpjekjet e radikalizimit në Kosovë.

Luftëtarët e huaj të kthyer do të vazhdojnë të paraqesin kërcënim ose të ndikojnë tek të tjerët në Kosovë, si p.sh. tek vëllezërit e motrat dhe të afërmit e tjerë, pasi ata shpesh do të shpërndajnë ideologji të dhunshme ekstremiste si bartës të narracioneve personale të konflikteve në Siri dhe Irak si dhe me ndjenjën e tyre të veçantë të krenarisë në themelimin e “Shtetit Islamik”. Përveç kësaj, ata që u vranë në konflikte në Siri / Irak, do të ndikojnë në komunitetin e tyre në Kosovë, duke ofruar një histori të martirizimit, të cilën, ata që u besojnë atyre, mund ta ndjekin në Kosovë apo në Lindjen e Mesme.

Ka tashmë indikacione që tregojnë vlefshmërinë e këtij argumenti. Për shembull, në korrik 2018, Policia e Kosovës në Skenderaj arrestoi një të afërm e dy ish luftëtarëve të huaj të vranë në Siri. Arrestimi ndodhi pasi policia kishte përgjuar planet e tij për të kryer një sulm terrorist në Kosovë.⁶² Rasti është dëshmi për ndikimin delikat që ish luftëtarët e huaj do të kenë në komunitetet e tyre. Vëllezërit e motrat e luftëtarëve të huaj dhe anëtarët e tyre të familjes qëndrojnë të lidhur dhe pas arrestimeve të të afërmeve të tyre, ato lidhje janë forcuar edhe më tej.⁶³ Një rast tjetër që ofron prova të mëtjshme të ndikimit të madh të luftëtarëve të huaj në vëllezërit e motrat dhe të afërmit e tyre, është komploti i penguar i qershorit 2018 i dy individëve në mesin e 6 të arrestuarve, burrë e grua, që kishin planifikuar të sulmonin forcat paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë dhe policinë vendore. Një kosovar 26 vjeçar me nënshetësi belge kishte planifikuar të kryejë sulme terroriste në Kosovë dhe Belgjikë. Plani i të dyshuarit kryesor ishte që e dashura e tij të kryejë një sulm vetëvrasës me bombë ndaj KFOR-

61 Deklarata e një personi që kishte planifikuar të sulmonte ekipin kombëtar izraelit të futbollit. Për më shumë shihni: <https://www.evropaelire.org/a/izraeli-ndeshja-sulmi-shqipëria/29235667.html>

62 Po aty:

63 Vrojtme nga intervista me familjen e LH nga Gjilani, qershor 2018. Intervistë me familjen e LH nga Prizreni, shkurt 2018.

it dhe në vende të frekuentura nga turmat e njerëzve në Kosovë.⁶⁴ E dashura e të dyshuarit është motra e G.H. që është arrestuar nga Policia e Kosovës për tentativë për të prodhuar një video propagandistike për IS. Këto dy raste ilustrojnë rrjetin e lidhur ngushtë të luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre si dhe nivelin e tyre të koordinimit në përhapjen e ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm.

Aktualisht, ekziston një numër i madh i luftëtarëve të huaj të Kosovës, të cilët janë ende të pranishëm në territorin e mbajtur nga IS. Qeveria e Kosovës ka shprehur gatishmërinë e saj për të mundësuar kthimin e tyre në Kosovë, në veçanti të grave dhe fëmijëve, të cilët konsiderohen si jo-luftëtarë. Derisa Qeveria e Kosovës ka pohuar se me këtë vendim ata po marrin hisen e tyre të përgjegjësisë, vendimi për të kthyer luftëtarët e huaj të Kosovës përbënë një nga kërcënimet kryesore ndaj sigurisë kombëtare të vendit për shkak të potencialit të tyre për radikalizimin e mëtejshëm në Kosovë. Pjesa më e madhe e atyre që kanë mbetur në zonat e konfliktit, aktualisht qëndrojnë në kampet kurde në Siri afër kufirit me Turqinë, dhe në kampet ndërkombëtare në Turqi.

Pa planifikim paraprak dhe pa programe për të lehtësuar kthimin e tyre, riintegrimi i ish-luftëtarëve të huaj do të jetë një nga sfidat më të vështira për Qeverinë e Kosovës dhe agjencitë e saj të zbatimit të ligjit për shkak të rezistencës së shoqërisë për të mirëpritur kthimin e këtyre individëve.

Pjesa më sfiduese e këtij procesi do të jetë integrimi i mbi 40 fëmijëve që kanë mbetur në ish-territorin e mbajtur nga IS. Disa nga këta fëmijë kanë lindur në një ambient të ndryshëm, pastaj janë rritur me një kulturë të ndryshme nga prindërit e tyre që përkrahën një ideologji ekstremiste, gjë që për hisedarët në Kosovë, e bën jashtëzakonisht të vështirë punën në deradikalizimin e tyre. Pjesa tjetër, janë fëmijët që kanë qenë 10 ose 12 vjeç kur kanë shkuar në Siri dhe Irak e tani janë 16 vjeç dhe tashmë i janë ekspozuar ideologjisë së IS,⁶⁵ gjë e cila tashmë ka ndikuar në personalitetin dhe sjelljen e tyre.⁶⁶ Në aspektin afatgjatë, këta individë do të jenë kërcënim i madh për sigurinë kombëtare të Kosovës.

64 "Detaje të reja nga tentim sulmi ndaj KFOR-it" Prishtinë, qershor 2018. Për më shumë shihni: <https://kallxo.com/detaje-te-reja-nga-tentim-sulmi-kunder-kfor-it/>

65 Databaza e QKSS 2018.

66 Intervistë me ekspertin e Kosovës mbi EDh, korrik 2018

LUFTËTARËT KOSOVARË NGA DIASPORA

Një numër i konsiderueshëm i individëve të Kosovës që u bashkuan me IS dhe organizatat e tjera terroriste në Siri dhe Irak janë nga diaspora, por kanë origjinë nga Kosova. Nga 255 luftëtarë të huaj nga Kosova që kanë shkuar në Siri dhe Irak, 48 individë ose 20% e totalit të të LHT të Kosovës⁶⁷ janë individë të rinj që nuk kanë lidhje me Kosovën ose që kanë lindur në një vend tjetër. Këta individë ose kanë migruar në vendet e Evropës Perëndimore gjatë viteve 1990-të ose kanë lindur nga prindër imigrantë që kishin shkuar atje dhe ishin vendosur në këto vende, tridhjetë vjet më parë.

Grafiku më poshtë tregon se numri më i madh i individëve të Kosovës që iu bashkuan IS, janë nga Gjermania, gjithsej 14, pasuar nga 6 individë nga Zvicra dhe katër nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.⁶⁸ Disa nga këta individë u kthyen në Kosovë ose në vendet e tyre të origjinës pas ndarjes së tyre me IS, ndërsa të tjerët u vranë në luftime.



Luftëtarët e huaj nga Kosova dhe nga diaspora

⁶⁷ Të dhënat e Policisë së Kosovës ofruar autorit, janar 2018.

⁶⁸ Po aty:

Përgjatë këtyre viteve, pjesëmarrja e disa pjesëtarëve të diasporës kosovare në sulmet terroriste ndërkombëtare është bërë një pikë shqetësuese kryesore. Shumica e atyre që u përfshinë në këto sulme, ishin individë që nuk kanë lidhje të forta me Kosovën, por që përfaqësojnë brezin e ri të migrantëve që kanë lënë Kosovën me familjet e tyre në moshë të hershme gjatë konflikteve të viteve 1990-të në Ballkan. Një shembull i tillë është ai që kishte përfshirë dy vëllezër, Hysen Sherifin (29 vjeçar, në kohën e paraburgimit) dhe Shkumbin Sherifin (23 vjeçar, në kohën e paraburgimit), të cilët janë dënuar nga gjykata federale e Qarkut Lindor të Karolinës së Veriut në SHBA, për komplotin për t'ua prerë kokën agjentëve federalë.⁶⁹ Vëllai më i madh, Sherifi, kishte lëshuar kërcënime të tilla nga qelia e tij e burgut, ndërsa kishte vënë në dispozicion vëllain e tij më të vogël në planifikimin e sulmit së bashku me individë të tjerë. Që të dy vëllezërit dhe anëtarët e familjes së tyre kishin imigruar në SHBA gjatë viteve 1990-të, në një moshë shumë të re.⁷⁰ Një shembull tjetër i ngjashëm përfshin rastin e Arid Ukës, i cili qëlloi dy ushtarë amerikanë në aeroportin e Frankfurtit më 2011, pas sulmeve të 11 shtatorit në SHBA. Uka ka lindur në vitet 1990-të në Gjermani, atje ku familja e tij migroi nga Kosova, rreth dyzet vjet më parë.⁷¹

Incidente të tjera që kanë përfshirë anëtarë të diasporës kosovare, kanë ndodhur në Turqi dhe Irak. Në Turqi, një burrë me origjinë kosovare, në mars 2012, ishte përfshirë në të shtëna ndaj ushtarëve dhe policëve turq në provincën Nigde, duke lënë tre vetë të vdekur dhe shumë të lënduar. Në Irak, Blerim Heta, një burrë me origjinë kosovare, i cili iu bashkua IS nga Britania e Madhe ku ai banonte, në mars 2014 vrau rreth 50 vetë në një sulm vetëvrasës në Bagdad.⁷² Kohëve të fundit, në qershor të vitit 2018, Policia e Kosovës arrestoi një burrë me origjinë kosovare, i cili ishte rritur në Belgjikë dhe kishte nënshtetësi belge, në mes të komplotit për një sulm terrorist mbi paqeruajtësit e udhëhequr nga NATO në Kosovë. Qëllimi i tij ishte të

69 US Department of Justice, "Convicted Terrorist Sentenced to Life in Prison for Plotting to Kill Witnesses in His Terrorism Trial," (2013) <https://www.justice.gov/opa/pr/convicted-terrorist-sentenced-life-prison-plotting-kill-witnesses-his-terrorism-trial>.

70 "Convicted US Terrorist Plotter Commissioned 'Murder-for-Hire Hit Men to Behead Witnesses for \$5,000 a Head' While in Prison," DailyMail Online (2012) gjendet në <http://www.dailymail.co.uk/news/article-2092141/Hysen-Sherif-US-terrorist-plotter-commissioned-hit-men-beheadwitnesses-prison.html>;

71 The Guardian, "Kosovan Albanian Admits Killing Two US Airmen in Frankfurt Terror Attack," The Guardian, 31 gusht 2011, <https://www.theguardian.com/world/2011/aug/31/kosovan-albanian-admits-killing-airmen>

72 Likmeta, B. (2014) "Turkey Arrests Albanians After 'Terror' Attack" Balkan Insight, gjendet në <http://www.balkaninsight.com/en/article/three-albanians-arrested-in-turkey-terror-attack>.

kryente sulme terroriste në Kosovë dhe Belgjikë në bashkëpunim të ngushtë me të dashurën e tij, e cila është motra e një individi tjetër të Kosovës të arrestuar për aktivitete terroriste.⁷³

Rastet e përmendura më sipër janë një dëshmi e rreziqeve të radikalizimit të diasporës së Kosovës dhe rrezikut të angazhimit të tyre në komplete terroriste. Derisa ky rrezik nuk lidhet vetëm me diasporën e Kosovës, pasi që fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm ka prekur shtresa të ndryshme të shoqërive perëndimore, ky raport argumenton se ai përbën një kërcënim të madh për këtë komunitet të veçantë për shkak të marginalizimit kulturor, sfidave të asimilimit dhe konfuzionit mbi identitetin.

Prandaj, duke pasur parasysh diasporën e madhe të Kosovës dhe ndikimin e saj politik dhe ekonomik në Kosovë, ekziston një nevojë urgjente për të rritur shtrirjen e Kosovës në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në radhët e diasporës së saj. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në mesin e të rinjve të diasporës, të cilët herë pas herë e gjejnë veten në margjina të shoqërive perëndimore, të paaftë për t'u integruar plotësisht, dhe për këtë arsye janë një pre e lehtë për grupet që mbështesin radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Në këtë situatë, qeveria e Kosovës dhe Bashkësia Islame e Kosovës duhet të rrisin bashkëpunimin e tyre për të monitoruar edukimin fetar që i ofrohet diasporës së Kosovës.

73 "Detaje të reja nga tentim sulmi ndaj KFOR-it" qershor 2018, Prishtinë. Për më shumë shih: <https://kallxo.com/detaje-te-reja-nga-tentim-sulmi-kunder-kfor-it/>

RADIKALIZIMI I VAZHDUESHËM I FAMILJEVE TË LHT

Fenomeni i luftëtarëve të huaj dhe i ekstremizmit të dhunshëm ka prekur një numër të madh familjesh në Kosovë. Ekzistojnë dy kategori të familjeve të prekura. Kategoria e parë përbëhet nga familjet, të afërmit e të cilëve iu bashkuan IS, por familja nuk u radikalizua në tërësi. Këto familje kanë bërë përpjekje të mëdha për të parandaluar të afërmit e tyre për të shkuar në Siri dhe Irak.⁷⁴ Kjo kategori ka bashkëpunim me autoritetet shtetërore në përpjekjen për të adresuar radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë dhe në përpjekjen për t'i kthyer të afërmit e tyre që kanë mbetur në Siri. Këto familje nuk janë prekur ideologjikisht nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi. Në këto raste, anëtarët e radikalizuar të familjes përjetojnë zakonisht një prishje me pjesën tjetër të familjes, ndërsa përpiqen të ndikojnë njëri-tjetrin në sistemin e tyre të vlerave. Këto familje kanë një marrëdhënie të fortë me komunitetin, të afërmit dhe autoritetet shtetërore.⁷⁵ Shumica e familjeve të luftëtarëve të huaj bien në këtë kategori.

Kategoria e dytë përbëhet nga familjet e luftëtarëve të huaj, të cilat janë të ndikuara ideologjikisht nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi. Ky raport gjeti se ato janë familje shumë konservatore, të stigmatizuara dhe të izoluara nga komuniteti e të afërmit, dhe kanë ndërveprime të kufizuara ose fare nuk kanë ndërveprime me autoritetet shtetërore.⁷⁶ Këto familje pohojnë se vendimi i të afërmit të tyre për t'u bashkuar me IS dhe për të marrë pjesë në konfliktet në Siri dhe Irak ishte i justifikuar. Ata i perceptojnë aktivitetet e policisë dhe institucioneve të tjera si të njëanshme dhe përpjekjet e deradikalizimit i konsiderojnë si një agjendë anti-muslimane.⁷⁷ Ata vazhdojnë të varren nga ndihma dhe përkrahja e organizatave fetare ose nga individë bashkëmendimtarë, që janë ende aktivë në Kosovë. Kjo asistencë merret në formë të qirasë, ushqimit dhe si mbulim i shpenzimeve të tjera ditore. Ata mbesin skeptikë për çdo lloj mbështetjeje nga autoritetet shtetërore.⁷⁸

74 Intervistë me vëllain e LHT-së nga rajoni i Gjilanit, dhjetor 2017

75 Intervistë me anëtarët e familjes së LHT nga Mitrovica, nëntor 2017

76 Intervistë me babanë e anëtarit të familjes së LHT nga Prizreni, dhjetor 2017

77 Intervistë me anëtarët e familjes së LHT nga rajoni i Gjilanit, dhjetor 2017

78 Po aty;

Radikalizimi dhe ideologjia e ekstremizmit të dhunshëm vazhdojnë të mbizotërojnë në familjet konservatore dhe të radikalizuara të luftëtarëve të huaj. Sipas një prindi nga Prizreni: “burgu është një privilegj që Allahu i dha birit tim për përpjekjet e tij për të mbrojtur muslimanët dhe Allahun. Me ndihmën e Allahut, djali im do ta kalojë këtë sfidë”.⁷⁹ Kjo është dëshmi e shkallës, në të cilën disa familje të luftëtarëve të huaj janë radikalizuar.

Këto janë familje të luftëtarëve të huaj që refuzojnë çdo ndërveprim me komunitetin dhe autoritetet shtetërore dhe mbajnë lidhjet e tyre me organizatat fetare dhe grupet joformale fetare që mbushin boshllëkun e lënë nga autoritetet shtetërore. Në shumicën e rasteve, individët që mbështesin familjet e radikalizuara të luftëtarëve të huaj, janë miq të ngushtë të luftëtarëve të huaj. Shpesh këta individë dhe grupet fetare formale e joformale i pengojnë familjet e radikalizuara që të krijojnë kontakte me komunitetin ose me autoritetet shtetërore, duke penguar kështu çdo përpjekje të ardhshme për pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e riintegrit.

Në ndërkohë, autoritetet shtetërore në nivel lokal dhe qendror po dështojnë t’u vinë në ndihmë familjeve të luftëtarëve të huaj dhe të kuptojnë nevojat dhe shqetësimet e tyre bazë. Duke i lënë këta të vetëm në ballafaqimin me sfida të ndryshme, ata kontribuojnë në mënyrë indirekte në izolimin e tyre të mëtejshëm dhe me këtë iu mundësojnë grupeve joformale që të mbushin me shpejtësi këtë hendek. Në shumicën e rasteve, familjet radikale të luftëtarëve të huaj janë familjet më të varfra në komunitetin e tyre, shpesh të kufizuar nga probleme të ndryshme shëndetësore, të cilat nuk mund t’i trajtojnë për shkak të gjendjes së tyre financiare. Për shembull, familja e një luftëtari të huaj nga Prizreni dhe nga Hani i Elezit, është familja më e varfër e qytetit. I vetmi person i aftë për punë është në burg dhe familja nuk ka mjete për jetesë dhe asnjë të ardhur. Ata nuk kanë shtëpi në pronësi dhe për strehim e ushqim varen nga një rrjet miqsh të luftëtarëve të huaj dhe të organizatave fetare. Kjo familje kurrë nuk ka kërkuar mbështetje nga autoritetet lokale, duke lejuar kështu grupet fetare joformale që të kontrollojnë marrëdhëniet dhe ndërveprimet e tyre.⁸⁰ Një shembull i ngjashëm gjatë hulumtimit për këtë raport, është hasur edhe në rajonin e Mitrovicës.⁸¹

Përkundër refuzimit të familjeve radikale të luftëtarëve të huaj për të komunikuar dhe për të krijuar një marrëdhënie me autoritetet shtetërore, qeveria duhet të bëjë maksimumin dhe të ndërhyjë në këto raste për të parandaluar radikalizimin e mëtejshëm.

79 Intervistë me babanë e anëtarit të familjes së LHT nga Prizreni, dhjetor 2017

80 Intervistë me babanë e anëtarit të familjes së LHT nga Prizreni, dhjetor 2017

81 Intervistë me anëtarët e familjes së LHT nga Mitrovica, nëntor 2017

KONKLUZIONET

Pas mposhtjes së IS, organizatat terroriste anembanë globit kanë ndryshuar strategjinë e tyre të veprimtimit. Si rezultat, kërcënimi nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi ka zhvendosur dinamikën e tij në nivel global dhe lokal. Pasi që IS nuk është në kërkim të luftëtarëve të huaj për të marrë pjesë në fushën e betejës, është shfaqur një kërcënim i ri i sulmeve në vend, bazuar në ideologjinë e IS. Zhvendosja në strategji ka çuar në një rritje të sulmeve terroriste në Evropë, shumica e të cilave janë kryer nga sulmuesit që janë “ujq të vetmuar”.

Trende të ngjashme u dëshmuar gjatë dy viteve të fundit në Kosovë, ku autoritetet kanë parandaluar me sukses disa komplete terroriste në Kosovë, duke identifikuar individët e përfshirë në sulmet e planifikuara, gjë që çoi në arrestimin e tyre.

Deri më tani, shumica e luftëtarëve të huaj të Kosovës, që u kthyen pas luftimeve me IS, janë duke u gjykuar ose janë dënuar për angazhimin e tyre në aktivitete terroriste. Përkundër numrit të madh të luftëtarëve të huaj të kthyer në Kosovë, angazhimi i tyre në veprimtarinë terroriste është relativisht i ultë. Nga 135 luftëtarët e huaj që u kthyen në Kosovë pas ndarjes me IS në Siri dhe Irak, 5 nga ta u përfshinë në planifikimin e sulmeve terroriste ose në incidente të tjera në Kosovë.

Megjithë rrjedhën e zvogëluar në mënyrë drastike të luftëtarëve të huaj nga Kosova në Siri dhe Irak, niveli i kërcënimit dhe shpërndarja e ideologjisë ekstremiste nuk kanë ndryshuar. Ekziston një numër në rritje i simpatizantëve të cilët kurrë nuk arritën të bashkohen me IS në zonat e konfliktit, por që kanë mbetur ideologjikisht besnikë ndaj IS.

Këta simpatizantë shpesh gjenden në rrjetet e luftëtarëve të huaj të IS, siç janë familjet, miqtë e largët dhe të afërmit. Ajo çfarë kontribuon në radikalizimin e tyre, është mungesa e marrëdhënieve midis mekanizmave shtetërorë dhe familjeve ideologjikisht radikale, që gjejnë mbështetje në grupet joformale dhe kundërshtojnë çdo bashkëpunim me shtetin.

Një sfidë të ngjashme paraqet edhe diaspora e madhe e Kosovës. Ashtu siç na tregojnë të dhënat zyrtare, një numër i madh i LHT-ve të Kosovës janë nga diaspora dhe ka një shqetësim në rritje që pas radikalizimit të tyre në vendet e Evropës Perëndimore, ata do të shohin gjithnjë e më shumë Kosovën si një vend ku ata mund të kryejnë sulme apo të zgjerojnë rrjetin e tyre ideologjik të simpatizantëve të Shtetit Islamik.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

323.285(496.51)(048.8)

Perteshi, Skender

Përtej shkaktarëve : kërcënimi i ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë : raport / Skender Perteshi. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2018. – 40 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-679 -84-8

ISBN 978-9951-679-84-8



9 789951 679848

www.qkss.org